



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Vlorë, më _____._____.2023

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Për hartimin e specifikimeve teknike të produkteve ushqimore është bazuar në përbërjen e menusë së miratuar të Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, dhe Urdhërit nr. 457, datë 13.06.2018, Për një ndryshim të Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, Hartimi i specifikimeve teknike, nga ana e Komisionit, është kryer duke iu referuar:

- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, për çdo artikull.
- Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar,
- VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”
- Udhezimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbulimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti”,
- Ligji Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.
- Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,
- Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”
- Ligjin nr. 9308 datë 04.11.2004, “Mbi shërbimin dhe inspektoriatin veterinar”, për normat e tregëtimit të zbatueshëm për vezët”
- Rregulloren nr. 1 datë 25.05.2002 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit
- Udhezimin nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
- Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, indryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.
- Ligjin nr. Nr. 87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregëtimin e vajitë ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 21.3.2017 Për miratimin e

rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”

- Udhëzimin nr. 207, datë 31.03.2015 i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave “Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t’u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”, Shtojca 3.
- Ligji nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”.

Malli të shoqërohet me certifikatë cilësie të lëshuar nga institucione të licensuara dhe raport analize të laboratorit.

Transporti: Të bëhet me mjete të pastra, të mbyllura, të cilat janë të destinuara për transportimin e prodhimeve ushqimore.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorëve të tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

1. Bukë gruri

BUKË ME MIELL GRURI - Bazuar ne STASH 1411/87

Lloji: Bukë gruri me miell rreze 75 %

Treguesit Organo-Leptikë:

Korja: E lëmuar, pa pjesë të djegura, pa çarje dhe shkëputje të kores nga tuli. Ngjyra e njëllojtë e kuqerremtë në kafe të çelët.

Tuli: Masa e njëllojtë e pjekur mirë, me pore të shpërndara mirë, në mënyrë të njëllojtë. Pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistenca elastike, jo i thërrmueshëm, pa shtresa.

Era dhe shija: E këndshme, karakteristike e bukës së pjekur mirë. Pa erë myku, thartirë dhe hidhërimi dhe erë e shije tjetër të huaj.

Forma: E rregullt, pa shtypje dhe deformime.

Lëndët e huaja: Nuk lejohen.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Lagështira në % jo më shumë se 45

Poroziteti në % jo më pak se 70

Aciditeti në gradë jo më shumë se 4.5

Ambalazhimi: Çdo bukë të futet në qese letre me masën 1000 gr ose 500 gr, këto të futura në kuti kartoni. Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.

Transporti i bukës: Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorëve të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

2. Bukë integrale

Bazuar ne STASH 1411/87

Lloji: Bukë integrale me miell integral, cilësi e parë.

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja : E rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie

Ngjyra : karakteristike e llojit të bukës integrale kafe e erret.

Konsistenca: Elastike me shtypje të lehtë, rikthehet në gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa. Poret të jenë të shpërndara njëlloj në të gjithë madhësinë.

Era dhe shija: e këndshme, e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj.

Pesha e bukës të jetë 1000 gr ose 500 gr. Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet t’i përgjigjet masës 3-4 orë mbas kohës së pjekjes.

Lëndët e huaja: Nuk lejohen.

Treguesit fiziko – kimik:

Lagështira në % jo më shumë se 49.

Poroziteti në % jo më pak se 67.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 7

Kripa në % jo më shumë se 2.

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.

Ambalazhimi: Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore. Buka duhet të jetë e prerë në feta.

Transporti: Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore. Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

3.Bukë thekre

Bazuar në STASH 1411/87

Lloji: Bukë thekre me miell thekre ,cilësia e parë

Treguesit shqisorë:

Pamja: E rregullt, pa shtypje, pa deformime ,pa shenja djegie

Ngjyra :Karakteristike e llojit të bukës së thekrës kafe e errët

Konsistenca: Elastike, me shtypje të lehtë,rikthehet në gjendje të parë,jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa.Poret janë të shpërndara në të gjithë madhësinë.

Era dhe shija:E këndshme e bukës së pjekur mirë.Pa erë dhe shije të hidhur ,të thartë myku ose të huaj.

Pesha e bukës :1000 gr ose 500 gr

Lëndët e huaja: nuk lejohen

Treguesit fiziko-kimikë:

Lagështira në % jo më shumë se 49

Poroziteti në % jo më pak se 67

Aciditeti në gradë jo më shumë se 7

Kripa në % jo më shumë se 2

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes

Ambalazhimi: Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore.

Buka duhet të jetë e prerë në feta.

Transporti: Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore. Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Fruta,perime

1.Mollë

Bazuar në STASH 1752/88

Lloji:Mollë për treg cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: të freskëta,me zhvillim normal,të shëndosha e me bisht.Me formë, ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime

Pjekuria: me 3 pjekuri teknike të njëjtë.

Era dhe shija: Pa erë dhe shije të huaj.

Madhësia e kokrrës (prerë gjerazi ,në diametrin më të madh)

Kultivarët me kokërr të zgjatur jo më pak se 70 mm

Kultivarët me kokërr të rumbullakët jo më pak se 80 mm

Kultivarët me kokërr të vogël jo më pak se 60 mm

Dëmtime mekanike nuk lejohen.Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen.Të kalbura, të ngrira,njolla nga Monilia (kalbëzim) lëndë të huaja nuk lejohen.

Nga krimbi (pa galeri në brendësi) nuk lejohen.

Nga fuzikladi (kroma e pikalorja) nuk lejohen.

Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë .Nuk lejohen

Gunga (kallo) njolla në lëkurë.Nuk lejohen.

Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen.Përmbajtja e pesticideve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Frutat ambalazhohen sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standartave dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti. Frutat mund të ambalazhohen dhe në qeska plastmasi, rrjeta ushqimore duke ruajtur freskinë dhe konsistencën e frutave.

2.Portokalle

Bazuar në STASH 1722/88.

Lloji: Portokalle për treg cilësia e parë.

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal, të shendoshë dhe me bisht.

Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 %. Me pjekuri teknike të plotë.

Ngjyra,shija dhe aroma: Ngjyrë karakteristike e kultivarit e verdhë në portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athet, pa shije të hidhur.

Madhësia e kokrrës (diametri më i madh) në mm jo më pak se 70.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen.

Lende të huaja nuk lejohen.

Gërvishtje në sipërfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre nuk lejohen.

Të prekura nga oleoza lejohen 2 – 3 njolla për kokërr.

Përmbajtja e pesdiciteteve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra. Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

3.Mandarinë

Lloji: Mandarina për treg cilësia e parë.

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: të freskëta, me zhvillim normal, të shendosha dhe me bisht. Me pjekuri teknike të plotë.

Ngjyra,shija dhe aroma: Ngjyrë karakteristike e kultivarit portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athet, pa shije të hidhur.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen. Lëndë të huaja nuk lejohen.

Gërvishtje në sipërfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre nuk lejohen.

Të prekura nga oleoza lejohen 2–3 njolla për kokërr.

Përmbajtja e pesdiciteteve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra. Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë të cilat të mbushura me fruta, vendosen në arka që të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

4.Patate

Bazuar në STASH 1729/88

Treguesit Organo-Leptikë të patates verore e dimërore:

Pamja e jashtme: Të plota, të forta, të pastra në sipërfaqe e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipik të kultivarit.

Pjekuria: Kokrra të pjekura.

Madhësia e kokrrës (diametri më i madh) mbi:

për të rrumbullaktat dimërore 5 cm; verore 4 cm.

për vezaket dimërore dhe verore 4 cm.
për të zgjaturat 3.5 cm.

Lejohen:

- a. lehtësisht të gjelbra jo me shume se 3 % për dimëroret; 1 % për veroret;
- b. të mbira jo më shumë se 1 % për dimëroret dhe nuk lejohen për veroret;
- c. lehtësisht të vyshkura jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 2 % për veroret;
- d. të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen;
- e. të kalbura nga lagështira vetngrohja, fitoftora, bryma, ngrica, nga sëmundje e dëmtues nuk lejohen;
- f. zgjebe me plagë deri në 1/5 e sipërfaqes së kokrrës jo më shumë se 1 %.
- g. njolla bojë hiri e ndryshkur deri në 1/5 e sipërfaqës së kokrrës nuk lejohen;
- h. dëmtime nga krimbi jo më shumë se 1 % .
- i. Dëmtime nga doseza nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Patatet ambalazhohen të ndara sipas kultivareve në arka. Patatet mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë.

5.Qepë e thatë

Bazuar në STASH 1755/88

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plotë.Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota.Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit.

Diametri (madhësia e kokrrës): për ovalet 4-8 cm. për llojet e tjera 5-10 cm.

Dëmtime mekanike: Cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja (cifla, bishta).

Me sëmundje: Nuk lejohen.

Të ngrira,të kalbura e të mykura: Nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi:Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta,të thata e të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike në fuqi .

Qepa e thatë mund të ambalazhohet edhe në rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë.

6.Qepë e njomë

Bazuar në STASH 1755/88

Lloji: Qepë e njomë cilësi e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: e freskët,e pastër ,e njomë,me ngjyrë të bardhë në jeshile,e pavyskur dhe e larë me ujë të pijshëm.

-Diametri në pjesën më të trashë,mbi 0.5-1.5 cm

-Gjatësia e kërcellit 15-25 cm

-Gjatësia e gjethit nga rozeta jo më shumë se 10 cm

-Sistemi rrënjor jo më shumë se 1 cm

-Dëmtime e sëmundje nuk lejohen

Ambalazhimi dhe etiketimi:Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta,të thata e të prodhuara .

7.Banane

Lloji: Banane cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: të freskëta ,me zhvillim normal, në tufë, me pjekuri teknike të plotë.

Ngjyra: të jetë jeshile në të verdhë, me erë dhe aromë të këndshme ,karakteristikë e këtij kultivari.Madhësia e kokrrës të jetë mesatare.

Demtime mekanike nuk lejohen.

Njolla të kafëta që tregojnë tejkalimin e pjekurisë nuk lejohen.

Gërvishtje të lëkurës nuk lejohen.

Zbutje të lëkurës nuk lejohen.

Ambalazhimi: të jetë në kuti kartoni standarte tipike për tregëtimin e bananes. Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë

8. Karrota

Lloji: Karrota për treg cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: Të freskët me ngjyrë portokalli në të kuqerremtë, formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë, të jenë të pastruar me ujë të pijshëm nga balta.

Përbërja e brendshme e tulit: Me tul të fortë, me bosht të hollë, me diametër jo më shumë se 1 cm.

Madhësitë: Gjerësia (diametri me i madh) deri në 4 cm, gjatësia 10 -15 cm.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkure) në % jo më shumë se 2.

Të prekura nga sëmundjet, insektet e të kalbura: Nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta, të thata.

9. Presh

Bazuar në STASH 1759/88

Lloji: Presh cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: i freskët, i pastër, i njomë, me ngjyrë të bardhë në jeshile, i pavyshkur dhe i larë me ujë të pijshëm.

-Diametri në pjesën me të trashë të jetë 2.5 - 3.5 cm.

-Gjatësia e kërcellit të jetë 25-45 cm.

-Gjatësia e gjethit nga rozeta, të jetë jo më shumë se 20 cm.

-Sistemi rrënjor jo më shumë se 1 cm.

Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta, të thata.

10. Spinaq

Lloji: Spinaq cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë të spinaqit:

Pamja e jashtme: I freskët, i pastër i njomë, me ngjyrë të jeshile, i pavyshkur dhe i larë me ujë të pijshëm, i lidhur në dëngje të vogla deri në 1 kg.

-Me rrënjë të prera

-Gjatësia e gjethit jo më shumë se 15 cm.

-Të mos ketë prani të barërave të tjera.

-Gjethet të jenë të plota deri në gjerësi deri në 10 cm dhe gjatësia e gjethes deri në 20 cm

Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen njolla ndryshku, dëmtime nga krimbat, pa dëmtime mekanike , të freskëta dhe të pavyshkura.

11. Bizele e freskët

Bazuar në STASH 1713-88

Treguesit Organo-Leptikë të bizeles kokërr:

Pamja e jashtme: Të njoma, të freskëta, të pastra e të paçara, me ngjyrë të kultivarit, me pjekuri teknike dhe madhësi normale të kultivarit.

Dëmtime mekanike, njolla ndryshku nga antraknoza, ndezje e kalbje, nuk lejohen.

Treguesit Organo-Leptikë të bizeles bishtajore:

Pamja e jashtme: Të freskëta, të njoma, të pastra, të pathyera, me ngjyre e madhësi të kultivarit.

Kokrrat në bishtajë: me madhësi normale të kultivarit, të zhvilluara mirë në fazën qumështore, me ngjyrë jeshile të hapur, me lëkurë të hollë, të njomë e të embël , pa shenja drunjëzimi.

Dëmtime mekanike, njolla ndryshku, nga antraknoza, ndezje e kalbje nuk lejohen.

12.Bizele kokërr frigoriferi

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr.645, dt.23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I,të Urdhërit nr.234,datë 20.05.2014,Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Treguesit Organo-Leptikë të bizeles kokërr të ngrirë:

Pamja e jashtme: Kokrra të plota,të shëndosha,me formë dhe madhësi sipas llojit(ovale,e rrumbullakët,e gjatë etj)

Ngjyra:jeshile e theksuar

Era dhe shija:Pa erë myku dhe çfarëdo erë tjetër të huaj.Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose erë të huaj.

Analiza mikrobiologjike:

1.Clostridium

2.E.Coli

3.Salmonella

Ambalazhimi:Bizelet e ngrira duhet të jenë të ambalazuara në ambalazh të përshtatshëm për perimet e ngrira.

Etiketimi:

Emertimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha Neto

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim:nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimor, këto të dhëna të jepen në ambalazh ose mbi etiketë.

Transporti:

Për arsye se produkti kërkohet i ngrirë,transporti kryhet me mjete frigoriferike në temperaturën (-17°C)

13.Speca

Bazuar në STASH 1756/88

Treguesit Organo-Leptikë të specës:

Pamja e jashtme: Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri normale,të pavyskura.

Dëmtime: Të mos ketë dëmtime të ndryshme e sëmundje,të mos jenë të kalbura, të mykura,të ngrira

Shija: Karakteristike e kultivarit. Nuk lejohet përzierje e specave djegës me ato jo djegës.

Diametri :për të gjatat jo më shumë se 4 cm, të rrumbullaktat jo më shumë se 9 cm

Gjatësia e bishtit jo më shumë se 3 cm.

Ambalazhimi bazuar ne standartin 1799/88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike perkatese në fuqi.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

14.Selino

Lloji: Selino, cilësi e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: i freskët, i pastër, i njomë, me ngjyrë të bardhë në jeshile, i pavyskur dhe i larë me ujë të pijshëm.

Gjatësia e kërcellit deri në 25-30 cm

Dëmtime e sëmundje nuk lejohen .

Ambalazhimi: Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

15. Erëza 50g tufe

Majdanoz

Lloji: Majdanoz cilësi e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: i freskët , i njomë, i pastër me ngjyrë jeshile të errët, i pa vyshkur ,pa dëmtime,pa lëndë të huaja,pa elementë të kalbur.

Me rrënjë të prera.

Të mos ketë prani të barnave të tjera.

Gjethet të jenë pa njolla të ngjyrës së ndryshkut, pa dëmtime nga krimbat, të freskëta dhe të pa vyshkura.

Borzilok

Lloji: Borzilok cilësi e parë

Treguesit Organo-Leptikë :

Pamja e jashtme: i freskët , i njomë, i pastër me ngjyrë jeshile të errët, i pa vyshkur ,pa dëmtime,pa lëndë të huaja,pa elementë të kalbur.

Me rrenjë të prera.

Të mos ketë prani të barnave të tjera.

Gjethet të jenë pa njolla të ngjyrës së ndryshkut, pa dëmtime nga krimbat, të freskëta dhe të pa vyshkura.

Kopër

Lloji: Kopër cilësi e parë

Treguesit cilësorë :

Pamja e jashtme: i freskët , i njomë, i pastër me ngjyrë jeshile, i pa vyshkur ,pa dëmtime,pa lëndë të huaja,pa elementë të kalbur.

Me rrenjë të prera.

Të mos ketë prani të barnave të tjera.

Gjethet të jenë pa njolla të ngjyrës së ndryshkut, pa dëmtime nga krimbat, të freskëta dhe të pa vyshkura.

16. Domate

Bazuar në STASH 1726/88

Lloji: Domate cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: Të freskëta, me formë tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pavrara, të pashtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të paprekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të palagura.

Pjekuria dhe ngjyra: Pjekuri normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të papjekura, të zbutura e të vyshkura.

Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen.

Të plasura e të vrara lehtësisht:

-Për llojet e mesme dhe të vona lejohen deri në 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara)

-Madhësia e kokrrës (diametri më i madh gjerësor), jo me pak se:

Për të hershmet 5 cm.

Për të mesmet dhe të vonat 7 cm.

Për të mesmet e të vonat kumbullore (gjatësia 5 cm)

Ambalazhimi bazuar ne standartin 1799/88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike të perkates ne fuqi. Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

17.Patërxhane

Bazuar në STASH 1730/88

Treguesit Organo-Leptikë të patëllxhanit:

Pamja e jashtme: Karakteristikë e kultivarit, të freskëta, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar me ngjyrë të zezë manushaqe me pjekuri normale me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura.

Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen. Të kalbura, të mykura, të ngrira nuk lejohen.

Madhësia:

a) diametri jo më shumë se: Për të gjatat 5 cm; Për të rrumbullaktat 12 cm; Gjatësia e bishtit jo më shumë se 4 cm

Ambalazhimi bazuar ne standartin 1799/88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike përkatës në fuqi.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorë te tjere atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

18.Hudhra

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plotë.Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota.Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 4 cm.

Diametri në cm (madhësia e kokrrës): për ovalet 3-5 cm

Dëmtime mekanike cifla, bishta, sëmundje,lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja (cifla, bishta). Me semundje nuk lejohen.

Të ngrira ,të kalbura e të mykura nuk lejohen.

19.Barbunja

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme :Të freskëta, të shëndosha të pastra, me fije normale për kultivarin dhe me fara që duken lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuara.Me formë prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të padrunjëzuara e pa fije.

Gjatësia në cm :

Barbunja frutshkurtër deri 6 cm

Barbunja frutgjatë deri 8 cm

Dëmtime të ndryshme (mekanike, sëmundje) nuk lejohen.Lejohet deri në 5% të partisë me vyshkje të lehtë.

Ngjyra: tipike për kultivarin. Lejohen deri ne 5% të masës me ngjyrë tjetër, me përjashtim të ngjyrës së zezë.

Ndërtimi i frutit: Fruta të butë me fara të vogla në fazën e qumështit.Lejohen me fruta jo të pjekura deri në 2% të masës.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

20.Brokoli

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme:Të jenë të freskët, të pjekur mirë, me formë të rregullt, pa dëmtime mekanike.

Të kenë ngjyrën karakteristike jeshile të fortë të brokolit me përmasa mesatare.

Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen. Të kalbura, të mykura, të ngrira nuk lejohen.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

21.Lulelakër

Lloji:Lulelakër cilësi e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: Të zhvilluara, me mbështjellje fletesh, e fortë në prekje.Lejohen lakra të pangjeshura deri 5% të partisë.

Pastrimi dhe gjatësia e koçanit: Të jenë të pastruara dhe me 2-3 gjethe të gjelbërta, të lidhura me koçanin i cili të jetë deri ne 3cm.

Dëmtime të ndryshme mekanike: Lejohen deri ne 5% e partisë me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shpërthyer si dhe të dëmtuara lehtësisht nga bryma.

Me sëmundje: Nuk lejohen.

Pesha e kokrrës :

-Për lulelakrën e hershme, jo me pak se 1 kg .

-Për lulelakrën me pjekje të mesme e të vona, jo më pak se 1.5 kg.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

22.Kungull Jeshil

Lloji :Kungull për treg cilësia e parë.

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: të freskët me ngjyrë e formë tipike të kultivarit , me perkulje të lehtë .

Përbërja e brendshme e tulit: Me tul jo shumë të fortë. Farat e pa zhvilluara e me lekurë të lëmuar.

Madhësite: Gjerësia(diametri më i madh) deri 3 cm.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lekurë) jo më shumë se 2%.

Të prekura nga insektet të kalbura nuk lejohen.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

23.Limon

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal ,të shëndoshë dhe me bisht.

Ngjyra, shija dhe aroma:ngjyrë karakteristike e kultivarit e verdhë me erë karakteristike dhe shije në të athët, pa shije të hidhur.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra, të forta, të thata e të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike përkatës në fuqi.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

24.Kastravec

Bazuar në STASH 1754/88

Treguesit Organo-Leptikë të kastravecit:

Pamja e jashtme: Të freskët me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, me perkulje të lehtë.

Përbërja e brendshme e tulit: Me tul të fortë e të lëngshëm. Farat e pa zhvilluara e pa kore të fortë.

Madhësitë: Gjerësia (diametri me i madh)deri në 5 cm

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lekurë) jo më shumë se 2%

Të prekura nga insektet, të kalbura: Nuk lejohen.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik ,duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

25.Kungull i verdhë

Lloji :Kungull i verdhë për treg cilësia e parë.

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: Të freskët me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë

Përbërja e brendshme e tulit: Me tul jo shumë të fortë. Farat e pa zhvilluara e me lekure të lëmuar.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lekure) jo më shumë se 2%.

Të prekura nga insektet, të kalbura nuk lejohen.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike perkatëse në fuqi. Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

26.Sallatë tufe

Lloji:Sallatë cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë të spinaqit:

Pamja e jashtme: e freskët, e pastër,e njomë, me ngjyrë të gjelbërt, i pavyskur dhe i larë me ujë të pijshëm.

Me rrënjë të prera

Të mos ketë prani të barërave të tjera.

Gjethet të jenë të plota

Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen njolla ndryshku, dëmtime nga krimbat,pa dëmtime mekanike, të freskëta dhe të pavyskura.

27.Pjeshkë

Lloji:Pjeshkë cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: kokrra të jetë e freskët, me zhvillim normal, me ngjyrë karakteristike të kultivarit, të pastra, pa bishta,me shije të ëmbël dhe erë karakteristike të kultivarit.

- Të jetë me pjekuri të plotë teknike.

- Madhësia e kokrrës të jetë për të hershmet deri në 50 mm, gjysëm të hershme deri në 55 mm dhe të vonshme deri në 60 mm.

- Dëmtime të lehta mekanike nuk lejohen.

- Dëmtime nga sëmundjet, insektet, dielli, ndryshim ngjyre të jetë jo më shumë se 5 %.

- Të mykura, të fermentuara, të kalbura dhe lëndë të huaja nuk lejohen.

Ambalazhimi: Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike perkatëse ne fuqi. Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjeno–sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

28.Dardha

Lloji:Dardhë cilësia e parë

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme:kokrra me zhvillim normal,të shëndosha, me ngjyrë karakteristike të kultivarit, me pjekuri teknike dhe me bisht.

- Madhësia e kokrrës jo më pak se 45 mm për dardhat e rrumbullakta dhe 40 mm për ato të gjata.

-Dëmtime mekanike lejohen deri ne 5 % te partisë së mallit.

- Nuk lejohet të jenë me sëmundje.

- Dëmtime nga bryma, ngrica, të lagura dhe lëndë të huaja nuk lejohen.

Ambalazhimi: Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike përkatëse në fuqi. Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Ushqime koloniale

1.Sheqer i paketuar

Bazuar në STASH 1413/87

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja e jashtme: Pluhuri i përbërë nga kristale të imët dhe të njëllojtë pa lëndë të huaja, të jetë i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet, pa copa sheqeri të ngjeshura.

Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

Ngjyra: e bardhë dhe me shkëlqim.

Era dhe shija: shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaja, kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.

Tretshmëria: tretet plotësisht në ujë, tretshmëria e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit Fiziko-Kimik:

Treguesit teknik:

-Sheqer i pastër i llogaritur në lëndë absolutisht të thatë jo më pak se 99.6%

-Lëndë reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0.1%

-Hiri jo më shumë se 0.07%

-Lagështi jo më shumë se 0.16%

Ambalazhimi: Të jetë me pako prej letre 1 kg, i etiketuar:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produkteve ushqimore, jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Malli duhet të shoqërohet me fletë analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

2.Oriz i paketuar

Bazuar në STASH 1738/87

Treguesit Organo -Leptike:

Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.

Ngjyra: E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

Era dhe shija: Karakteristikë e orizit të shëndoshë pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit Fiziko-Kimik:

Lageshtia: jo më shumë se 15 %

Aciditeti 0.081%

Lëndë të huaja jo më shumë se 0,4%.

Kokrra të thyera më të vogla se gjysma jo më shumë se 12%.

Lëndë minerale nuk lejohen.

Kokrra të verdha jo më shumë se 4 %.

Kokrra të pazhveshura nuk lejohen.

Të mos përmbajë dëmtues të gjallë ose të ngordhur.

Ambalazhimi: Të jetë me pako qese, 1 kg, i etiketuar, me afat skadimi deri në një vit, i shoqëruar me fletë analiza.

Orizi i cilësisë së parë duhet të ketë më pak se 30% të kokrrave të copëtura, të mos jenë të miellizuara. Etiketimi të përmbajë:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produkteve ushqimore, jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Malli duhet të shoqërohet me fletë analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

3.Vaj Vegjetal Lule Dielli i Rafinuar

Bazuar në STASH 2121/87

Treguesit Organo-Leptike:

Pamja në 20°C: Lëng vajor, i qartë, pa depozitime

Ngjyra: E verdhë e lehtë

Era dhe shija: E mirë karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.

Treguesit Fiziko – Kimikë:

Aciditeti jo më shumë se 0,4 mg KOH /gr vaj ose në Acid Oleik 0,2gr / 100 gr vaj

Lagështia dhe lëndët fluturuese në 105 grade C jo më shumë se 0.2%.

Dendësia relative në 20 gradë 0,918-0,923

Numri i sapunifikimit (mg KOH/gr vaj 188-194)

Treguesit i refraksionit =1467-1469.

Treguesi i jodit 110-143.

Lëndë të pasapapunifikueshme: jo më shumë se 15 gr/kg.

Ambalazhimi Dhe Etiketimi

Vaj lule dielli i rafinuar të jetë i ambalazhuar në shishe plastike, të mbyllura me tapë plastike me vidhëzim hermetik të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shenohet:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit

në institucion. Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mirë. Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raportë analizë të laboratorit. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

4.Makarona spaghetti

Bazuar në STASH 1170/87

Treguesit Organiko-Leptike:

Forma: Makarona spaghetti

Pamja e jashtme: Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër. Makarona spaghetti, me gjatësi 25-30 cm, me diametër 2-2.5 mm.

Pas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkurçime.

Ngjyra: E bardhë me nuancë të verdhë, në thyerje qelqore me jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

Era dhe shija: E mirë, karakteristikë e makaronave pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë:

Lagështia jo më shumë se 13%.

Aciditeti: Acid sulfurik jo më shumë se 0,16%.

Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.

Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Makaronat të jenë të ambalazuara me qese polietileni nga 0.5 deri 1 kg, të mos jenë të miellezuara, të tregohet koha e zierjes dhe tregues të tjerë:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Malli duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

5. Makarona t vogla

Bazuar ne STASH 1170/87

Treguesit Organiko-Leptike:

Forma: Makarona të vogla

Pamja e jashtme: Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lemuar deri lehtësisht të ashpër . Pas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkurçime.

Ngjyra: E bardhë me nuancë të verdhë, në thyerje qelqore me jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

Era dhe shija: E mirë karakteristikë e makaronave pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë

Lagështia jo më shumë se 13%.

Aciditeti: Acid sulfurik jo më shumë se 0,16%.

Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.

Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Makaronat të jenë të ambalazuara me qese polietileni nga 0.5 deri 1 kg, të mos jenë të miellezuara, të tregohet koha e zierjes dhe tregues të tjerë:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Malli duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

6. Miell i paketuar

Bazuar ne STASH 1455/87

Udhëzim nr.207 dt 31.03.2015 "Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t'u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore"

Lloji: Miell gruri

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja: Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja. Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

Ngjyra : E bardhë me nuancë të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit. Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.

Era dhe shija: Karakteristikë e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur, të thartë dhe pa erë e shije të huaj. Nuk lejohen kercitje.

Treguesit Fizike Dhe Kimike :

-Lagështira jo më shumë se 14%.

-Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata jo më shumë se 0.115 %

-Hiri i tretshëm në lëndën absolutisht të thatë jo më shumë se 0.9%

-Hiri i patretshëm në acid klorhidrik 10%; në lëndën absolutisht të thatë jo më shumë se 0.1%.

-Mbisitja (imtësia e bluarjes). Për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra:

Në sitën metalike nr.54, jo më shumë se 2%.

Në sitën e mëndafshte 5 xxx, jo më shumë se 5%.

-Gluteni i njomë jo më pak se 25%.

-Lëndë minerale: nuk lejohen.

-Përzjerje metalike: plumbi, zinku e bakri nuk lejohen. Lejohet përmbajtja e hekurit në formë thërrmijash nën 0.3 mm, jo më shumë se 3mg/g

-Mikroorganizma patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë. Nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe transportimi. Ambalazhimi në pako letre me peshë 1kg. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhënat e mëposhtme:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimor, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferike duke zbatuar rregullat higjienosantare për transportimin e produkteve ushqimore. Malli të shoqërohet me certifikatë origjinë dhe raportë analize të laboratorit.

7.Cokokrem

Të jetë cilësi ekstra, masë homogjene në trajtë kremi me kakao, lajthi, dhe qumësht pluhur, pa konservues. Ambalazhimi hermetik me vazo plastike ose qelqi me etiketë me peshë 1 kg.

8.Kripë e jodizuar e paketuar

Bazuar në STASH 1437/01.07.1995

Ligji nr 9942, datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut"

Lloji: Kripë ushqimore e përpunuar dhe e bluar për përdorim në kuzhinë.

Treguesit Organo-Leptikë:

Pamja : Masë kokrrizore

Ngjyra : E bardhë

Era dhe shija : E kripur pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

Imtësia në mm 0.2 – 2 .

Klorur Na në lëndën e thatë në %,jo më pak se 98.

Klorur Mg në lëndën e thatë në %,jo më shumë se 0.3.

Sulfat Mg në lëndën e thatë në %,jo më shumë se 0.9.

Sulfat Ca në lëndën e thatë në %,jo më shumë se 0.2.

Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %,jo më shumë se 0.3

Lagështirë në %,jo më shumë se 1.

Jodur kaliumi mg/kg 50 + - 3.

Kripa të plotesoje të gjithë kërkesat higjieno-shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi: Të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimore.

Marketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

